

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve spitalore” / (Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomikë - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muajor)**

**REF-35976-01-24-2025**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**90524400-0 / Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

fondi limit / vlera e pritshme e kontratave: **47 355 000** (dyzete e shtate million e treqind e pesedhjetë e pese mijë) leke pa TVSH dhe **481 298.91** (katerqind e tetembedhjetë mijë e dyqind e nentedhjetë e tete pike nentedhjetë e nje) **Euro**

SHËNIM: Sipas Bankës së Shqipërisë VLERA E KËMBIMIT VALUTOR me datë 24/01/2025 është 98.39

**Burimi i Financimit : Buxheti i Shtetit**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Spitali Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Lloji i procedurës është përzgjedhur në zbatim të nenit 42 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar, “Vendimit të Këshillit të Ministrave 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nenet 47; 59; 60 pika 1 germa ç; 61; 62; 63 pika 1; 64 pika 1 germa a; 65, VKM nr. 291, datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik” Lidhur me prokurimin e këtij objekti, janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të marrëveshjes kuader të tilla si specifikimet e sakta teknike, kushtet e rendesishme të kryerjes së shërbimit , sasitë e pritshme të kërkuara, specifikimet e sakta teknike, termat e references”. Kjo procedure zhvillohet nisur nga nevojat e Spitalit Rajonal Fier për evadimin dhe trajtimin e mbetjeve spitalore në funksion të dhenies së një shërbimi sa me cilësor kundrejt pacientëve

Kohezgjatja e kontratës është përcaktuar në bazë të kërkesës së sektoreve dhe urdherit të titullarit nr.5248, datë 17.12.2024

Procedura Marrëveshje Kuadër me një Operator Ekonomik, ku të gjitha kushtet janë përcaktuar, Lloji i procedurës është përzgjedhur në zbatim të nenit 42, 52 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në zbatim të nenit 47, 58, 59, 61, 63, 64 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Lidhur me prokurimin e këtij objekti, janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të marrëveshjes kuadër të tilla si specifikimet e sakta teknike, termat e references, kushtet e rëndësishme të kryerjes së shërbimit si dhe sasitë e pritshme

Me qëllim garantimin e kryerjes së shërbimeve në afatet kohore të përcaktuara nisur dhe nga specifika që ka ky shërbim, MK me një OE të vetëm fitues do të garantonte sigurinë e ofrimit të shërbimit sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK nisur kjo dhe nga eksperiencia e viteve të mëparshme

Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me vonesa në afatet për kryerjen e shërbimit duke patur parasysh rëndësinë e kryerjes së shërbimit të trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore në kohën e duhur si dhe investimin e kërkuar. Lidhja e MK me një OE, shoqërohet me mirëorganizimin e këtij të fundit për sigurimin e shërbimit në kohë, sigurimin e një back up-i dhe përmbushjen e shërbimit në kohën e kërkuar nga AK. Gjithashtu siguria për kontratat që parashikohet të lidhen, i jep mundësi OE të ulë kostot e ofertës.

Marrëveshja kuadër me disa OE ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara nuk konsiderohet kontratë. Kjo do të thotë që AK nuk kanë mekanizma detyruese për OE të shpallur të suksesshëm për pjesëmarrjen e tyre në minikonkurse dhe rrjedhimisht në lidhjen e kontratave pas zhvillimit të tyre. Pasiguria dhe vonesat mund të sjellin dështime në kryerjen e shërbimit të trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore për spitalet në kohën e duhur, duke patur impakt direkt tek mjedisi dhe publiku i gjere.

Me qëllim garantimin e kryerjes së shërbimit në afatet kohore të përcaktuara, MK me një OE të vetëm fitues do të garantonte sigurinë e kryerjes së shërbimit sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet dhe cilësi në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

Bazuar dhe në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar nën 24 në titullin "Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët" pikat 2 dhe 4 ku përcaktohet se

*pika 2 "Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze".*

*pika 4. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, autoriteti/ enti kontraktor konverton vlerën e ofertës së paraqitur në një monedhë e huaj, të përzgjedhur prej tij në dokumentet e tenderit, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës*

DST dhe procesi verbal i argumentimit të kriterëve janë hartuar në gjuhët shqip dhe anglisht.

*Bazuar në nenin 39 të LPP-së i ndryshuar dhe në nenin 42 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor vendos të mos e ndajë procedurën e prokurimit në lotë për arsye sepse kjo garanton dhe siguron efektivitet në lidhje me shpejtësinë e kryerjes së shërbimeve. Mos-ndarja në lotë garanton siguri dhe shërbimeve të kërkuara sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK. Gjithashtu procedura jo e ndare në lotë krijon lehtësi dhe efektivitet të kryerjes së shërbimit pasi rrymat e mbetjeve objekt prokurimi terhiqen në të njëjtën kohë dhe nuk krijon konfuzion si tek OE ashtu dhe tek AK nisur kjo dhe nga eksperiencat e mëparshme të AK*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Spitali Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **1- Kriteri i përzgjedhjes së fituesit:**

### **B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim**

*Kriteri i përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar bazuar në nenin 87, pika 1, 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 45 pika 1,2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar.*

**Fondit limit / vlera e pritshme e kontratave : 47 355 000** (dyzetë e shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë) leke pa TVSH

Fondi limit është perlllogaritur bazuar në V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nën 76 nën titullin “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” pika 1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

germa c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

referuar në rastin konkret Autoriteti Kontraktor në perlllogaritjen e fondit limit është bazuar çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vete AK të tregut pasqyruar në proces verbalin nr.5152.prot date 18.12.2024 të Grupit të punës për perlllogaritjen e fondit limit.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;*

d. *Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

### **a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

### **b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

### **c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;**

### **d. Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;**

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku është e parashikuar se:

*1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*

*2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për metoda dhe teknologji të trajtimit të mbetjeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", në VKM nr.798, datë 29.9.2010 "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore" dhe në Termat e Referencës së DST, ose teknologji ekuivalente, Operatori Ekonomik duhet të disponoje:

2.1.1 Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit me autoklavim me avull (sterilizimi)

a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe

b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*) që të përfshijnë kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:

- 18 01 01 - Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03);
- 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet;

2.1.2 Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponoje:

a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës

si dhe

b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:

- 18 01 02 - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03);
- 18 01 08 - Medikamente citostatika dhe citotoksike;

**Argumentim :** Keto dy kriteret pra pikat 2.1.1 dhe 2.1.2 janë vendosur në zbatim të nenit 77 pika pika 1/a dhe 2 dhe nenit 41, pika 4/ a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose. Njesia e Prokurimit ka konkluduar për vendosjen e kriterëve të përcaktuar në pikat 2.2.1.1 dhe 2.2.1.2 me argumentat tekniko-ligjorë si vijon:

*Normativa sektoriale në fushën e administrimit të mbetjeve spitalore perbehet nga Vendimi i Keshillit të Ministrave nr. 798, date 29.09.2010 "Per miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore", dhe Udhëzuesi Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore i nxjerrë në zbatim të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 798, date 29.09.2010 "Per miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore", përcaktohet sa vijon:*

*Kreu I Pika 4. Roli i organeve shtetërore : a) Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Shëndetësisë hartojnë standardet e administrimit të mbetjeve spitalore; b) Ministria e Shëndetësisë siguron kushte për aplikimin e standardeve të administrimit të mbetjeve spitalore."*

*Kreu II "Detyrimet e prodhuesve të mbetjeve spitalore" Pika 5. Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për: a) grumbullimin e kontrolluar të mbetjeve spitalore pranë institucionit shëndetësor; b) ndarjen e mbetjeve spitalore të parrezikshme (të llojit urban) nga mbetjet spitalore të rrezikshme; c) ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe asgjësimin në mënyrë të përshtatshme, të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre; d) shpenzimet e transportit, asgjësimit ose riciklimit të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre. Kjo përgjegjësi është e pashmangshme dhe e pavarur nga përgjegjësia e ndonjë personi të tretë të ngarkuar nga prodhuesi, për të ndërmarrë këto veprimtari; e) të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre."*

*Kreu III "Trajtimi i mbetjeve spitalore" ; 8. Çdo prodhues i mbetjeve spitalore është përgjegjës për trajtimin e mbetjeve që nga prodhimi, grumbullimi, ndarja, transporti, magazinimi, përpunimi dhe deri tek asgjësimi i tyre." ; 8.1 Çdo prodhues ndan që në burim elementet e rrezikshme nga ato të parrezikshme të mbetjeve spitalore, sipas rregullores së brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore dhe i magazinon ato të ndara; 8.10 Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore kryhet me metodat sipas shtojcës 3."*

"SHTOJCA 3 - METODA PËR TRAJTIMIN DHE ASGJËSIMIN 1. Incenerim 2. Autoklavim: a) Presion, b) Presion – avull, c) Presion – avull – copëtim. 3. Sterilizim me mikrovalë 4. Sterilizim - UV 5. Trajtim kimik/dizinfektim: a) me shkumës të kloruar; b) me klor aktiv (klor të lirë); c) me peroksid hidrogjeni (H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>); d) me glutinimin e proteinave nëpërmjet përdorimit të acideve; e) me ozon (O<sub>3</sub>);

10.1 Grumbullimi, transportimi, përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore kryhen nga organet kompetente shtetërore, personat juridikë publikë, si dhe personat fizikë apo juridikë privatë, që janë pajisur me lejen përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie."

Nga ana tjetër, Udhëzuesi Kombëtar i Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore, në pikën 7.1 (fq.20) percakton sa vijon: "Tabela 1 me poshte paraqet rrymat kryesore te mbetjeve te prodhuara brenda nje institucioni shendetesor dhe sistemin e kodimit me ngjyra që duhet të zbatohet per te menaxhuar mbetjet ne menyre efektive dhe te sigurte. Ajo tregon gjithashtu metodat e ndryshme te trajtimit dhe te asgjesimit per tu përdorur ne administrimin e tyre." Ne kete Udhëzues, në fq.21, jepet Tabela 1 jane te percaktuara rrymat e ndryshme te mbetjeve dhe metodat per trajtimin dhe asgjesimin e seiciles rryme.

Ne kushtet e mesipërme, duke u bazuar ne objektin e prokurimit i cili perbehet nga rryma te ndryshme mbetjesh, per te cilat sipas dispozitave te sipërcituara duhen aplikuar metoda te ndryshme trajtimi dhe asgjesimi.

Sic edhe përcaktohet ne Tabelen 1 te Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore, mbetjet që i përkasin rrymave të mbetjeve infektive (18 01 01 dhe 18 01 03) trajtohen me metodat e nxehtesise, ndersa mbetjet qe i perkasin rrymave te mbetjeve Mbetje citotoksike (18 01 08), Pjese trupi të dallueshme, Placenta etj (18 01 02), trajtohen me metodën e incenerimit. Me tej, ne Kreun 11 te Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore percaktohen edhe kushtet e vecanta qe duhet te plotesohen per cdo metode trajtimi/asgjesimi.

Pra bazuar ne legjisllacionin perkates per Lejet e Mjedisit dhe ate per lejet dhe licensat, ka percaktuar ne menyre specifike qe Lejet Mjedisore dhe Licensat respektive për trajtimin/asgjesimin e mbetjeve jane qartesisht të diferencuara sipas metodave te trajtimit/operacioneve të licensuara, ne raport me rryma te vecanta te mbetjeve qe trajtohen.

Në shtojcën 1 pika 5 "Lejet e mjedisit të tipave A, B në varësi të kapacitetit prodhues kufi" të Ligjit Nr 10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar, përcaktohet:

"Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të njëjtin nëntitull Si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mblidhen bashkë. Nqs nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti kufi nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo.

	ID	Veprimtaria	Kapaciteti kufi për lejet e Tipit A	Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B
<b>Menaxhimi i Mbetjeve</b>	5.1	<b>a. Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi</b>	<b>Të gjitha instalimet</b>	-----
	5.3	<b>a. Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1.a) ose lëndfillimit (5.2 a)</b>	<b>Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10 ton/ditë</b>	<b>Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq</b>

Pra, rezulton se sipas Ligjit Nr 10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit"i ndryshuar, Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 798, date 29.09.2010 "Per miratimin e rregullores per administrimin e mbetjeve spitalore" dhe Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore i nxjerrë në zbatim të Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 798, date 29.09.2010 "Per miratimin e rregullores per administrimin e mbetjeve spitalore" se :

a) asgjesimi i mbetjeve të rrezikshme: Mbetje citotoksike, Medikamente, Kimikate te tjera farmaceutike, Pjese trupi të dallueshme, Placenta etj.(kodet, 18 01 08, 18 01 02) bëhet në një instalim incenerimi dhe për këtë operacion, lëshohet vetëm leje mjedisore e tipit A (III.1.C), për të gjitha volumet dhe instalimet.

Per kete arsye eshte kerkuar Leja me kod III.1.C (Tipi A) me metodën e incenerimit per mbetjet me kod 18 01 02 , 18 01 08 ndersa trajtimi i mbetjeve që i përkasin rrymave të mbetjeve infektive (18 01 01 dhe 18 01 03) bëhet me metodën e nxehtesise (autoklavimit) dhe për këtë operacion mund të lëshohet edhe leje e Tipit B (III.1.B) edhe Leje e Tipit A

(III.1.C), në varësi të volumeve/kapacitetit që lejohen për trajtim. Për këtë arsye është kërkuar Leja me kod III.1.B (Tipi B) me metodën e autoklavimit për mbetjet me kod 18 01 01 dhe 18 01 03).

2.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat si me poshtë vijon:

- a ISO 9001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Cilesisë) ose ekuivalent;
- b ISO 14001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Mjedisit) ose ekuivalent;
- c ISO 45001:2018 (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë) ose ekuivalent

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe brenda afatit të vlefshmerisë.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

*Ky kriter është në përputhje dhe me pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

*ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime me të ulta. ISO 9001:2015 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanimit i njohur si standardi që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standard aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit. Një sistem menaxhimi i cilësisë i certifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe proven e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit*

*ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike.. ISO 14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të mjedisit për të mundur një organizatë për të zhvilluar dhe zbatuar një politikë dhe objektivat të cilat marrin parasysh kërkesat ligjore dhe kërkesat e tjera në kuadër të zbatimit, ruajtjes dhe përmirësimit të menaxhimit të mjedisit. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit*

*ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjes me sukses të kontratës së shërbimit objekt prokurimi. ISO 45001 ka për qëllim të jetë i zbatueshëm për çdo organizatë pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra e saj. Të gjitha kërkesat e këtij standardi synojnë të integrohen në proceset e menaxhimit të një organizate. Ky standard mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, do të ndihmojë organizatat që ta zvogëlojnë barrën e lëndimeve dhe sëmundjeve në*

vendin e punës, duke ofruar një kornizë për të përmirësuar sigurinë e punonjësve, për të zvogëluar rreziqet në vendin e punës dhe për të krijuar kushte më të mira pune.

*Çertifikatat e kërkuara janë brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik dhe janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e shërbimeve duke patur parasysh se shërbimi i kërkuar është një shërbim teper sensitiv dhe ka impakt në mjedis.*

Gjithashtu të gjitha certifikatat ISO të sipercituara janë vendosur konform 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar nën titullin “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” pika 1 ku përcaktohet se “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” si dhe në zbatim të rekomandimit të APP dhe DPA datë 20.03.2018

2.1.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt Miratimin Higjieno –Sanitar respektiv për objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të lëshuar nga ISHSH (Inspektorati Shëndetësor Shtetëror);

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur konform ligjit nr.7643, datë 12.12.1992, “Për shëndetin publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror” me gjithë ndryshimet nëni 10, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr.798, datë 29.9.2010 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE” me gjithë ndryshimet KREU IV nën titullin “Leja mjedisore dhe aktmiratimi higjieno-sanitar” pika 10.3 pasi shërbimi i cili kërkohet në këtë procedurë ka të bëjë me mbetje spitalore të cilat në rast nëse trajtimi dhe magazinimi i tyre nuk kryhet konform rregullave mund të kthehen në burim infeksioni.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ose 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të përlllogaritur.

**Shënim\*:** Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera do të aplikohet mbi vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Ky kriter, është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020,”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar, nëni 43 pika 1 dhe pika 2 germa ”a”, parashikohet periudha kohore dhe marzhi maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur mbi kufirin e lartë monetar, konkretisht:

Në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

### **Neni 43 Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare**

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohë :

a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte mbi kufirin e lartë monetar bazuar ne vleren e fondit limit, AK ka marre parasysh praktikat e vendosur ndër vite te cilat kane rezultuar e suksesshme, lidhur me vendosjen e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e Prokurimit Publik ne teresi. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Vlera e xhiros se percaktuar eshte brenda marzhit te caktuar ne bazen ligjore te sipercituar.

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' i ndryshuar ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; si dhe në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2023, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë patur afat deri më 31.03.2024.

Gjithashtu me qellim mos penalizimin e asnje operatori ekonomik ky kriter eshte lene me alternative pra nje operator ekonomik mund te paraqese vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ose 2022, 2023, 2024 pasi afati per dorezimin e deklaratave vjetore te vitit 2024 sipas dispozitave te sipercituara eshte deri ne date 31.03.2025

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit të limit të kesaj procedure prokurimi.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara..

Permbushja e njerit prej kriterëve te mesiperm e ben oferten te vlefshme



**Shënim\*:** Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera do të aplikohet mbi vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me Ligjin nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar nenit 77 pika 4 ku percaktohet se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me Vendimin e Keshillit të Ministrave nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar neni 41 pika 3 ku percaktohet se: 3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :**

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar neni 77 dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar neni 41 pika 3 ku percaktohet se: 3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK pasi në rastin aktual kemi të bëjmë me një shërbim teper sensitiv i cili ka impakt në mjedis por edhe në shëndetin e njerëzve.*

**2.3.2** Operatori duhet të ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, minimalisht 2 automjete të cilat duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e pikës 8.8/c dhe Shtojcës 4 të VKM Nr. 798, date 29.09.2010 "Per miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore" dhe të pikës 9.3.3. të Udhezuesit Kombëtar "Administrimi i sguert i Mbetjeve Spitalore". Për të vërtetuar përbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

➤ **Për automjetet në pronësi:**

- *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*
- *Leje qarkullimi,*
- *Akt - kolaudimi*
- *Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt -Miratimet Higjenosanitare,*
- *Foto te mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese.*

➤ **Për automjetet që nuk janë në pronësi:**

- *Kontratë qiraje ose huapërdorje brenda afatit te vlefshmerise te shoqeruar me aktin e pronesise se qiradhenesit/pronarit.*
- *Leje qarkullimi e mjetit;*
- *Akt kolaudimi;*
- *Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet*
- *Fotot e mjeteve dhe Akt – Miratimet Higjenosanitare.*

**\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e te dhenave te mjeteve nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.**

**Shenim:**

*Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” me gjithë ndryshimet nenet 92; 79 178.; ligjin nr.7643, date 12.12.1992, “Për shëndetin publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror” me gjithë ndryshimet neni 10, Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore dhe pika 4/ç e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ne funksion te rritjes se sigurise pasi transporti i mbetjeve spitalore kryhet me mjete te posacme. Duke marrë në konsideratë faktin se shërbimi objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër elementet e tij edhe transportin nga AK në ambientet e trajtimit të operatorit ekonomik, si dhe te produkti final nga ambientet e operatorit drejt landfillit, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën me qëllim ekzekutimin e objektit të prokurimit. Perlllogaritja e numrit minimal te automjeteve te kerkuara eshte bere duke marre parasysh fillimisht, qe automjetet qe do të përdoren për këtë lloj shërbimi do të jenë të llojit furgona qe nuk e kalojnë peshen totale me gjithë ngarkesë 3.500 kg, pasi keto kategori automjetesh jane te manovrueshme për të qarkulluar në ambientet spitalore. Kapaciteti i zakonshëm i këtyre lloj automjetesh varion nga 500 kg deri në 1.300 kg. Përlllogaritja merr ne konsiderate faktin qe frekuenca e kerkuar e terheqjes eshte javore dhe qe OE realizon sherbime edhe ne kliente te tjere te shperndare ne territor dhe qe ne disa raste volumi javor i grumbulluar nga AK mund ta kaloje kapacitetin e vetem nje automjeti, si dhe nevojat per sherbime qe ka here pas here cdo automjet. Nga sa me siper nevojiten minimalisht 2 Automjete per te kryer sherbimin objekt te Marreveshjes Kuader.Gjithashtu eshte lene dhe opsioni i marrjes se mjeteve me qira ne menyre qe te mos penalizojte asnje operator ekonomik te interesuar

**2.3.3.** Operatori Ekonomik duhet ta ketë minimalisht jo më pak se 10 persona të punësuar për muajin dhjetor 2024 ose janar 2025. Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore;
- Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për muajin dhjetor 2024 ose janar 2025.

\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e numrit të punonjësve nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.

**Shenim:**

*Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”*

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha shërbimeve duke pasur të punësuar dhe rregjistruar në listpagesën e muajit dhjetor 2024 ose janar 2025 ose me kontrate shërbimi:

- Minimumi 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Për këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese :

- Librezë pune
- CV përkatëse
- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme
- Diplomë

\* **Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e emrit të Inxhinierit nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.**

**Shenim:**

*Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Argumentimi për kriteret në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4:** Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku përcaktohet se : “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike.....” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore

të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore minimale të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pra që kanë në dispozicion për përmbushjen e kësaj kontrate.

Numri i përcaktuar i punonjësve të kërkuar me sipër argumentohet si më poshtë:

*numri i punonjësve është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimit dhe përlllogaritjen e burimeve njerëzore minimale të nevojshme për realizimin e elementeve të shërbimit si dhe fakti që punonjësit janë objekt i Kodit të Punes, pra duhet të punojnë 40 ore pune në javë si dhe gëzojnë të drejtën e pushimeve vjetore 28 dite në vit. Në këto kushte një OE në këto lloje shërbimi me kapacitete optimale, që të ofrojnë në mënyrë të qëndrueshme shërbimin e kërkuar duhet të ketë një punësim mesatar mujor prej minimalisht 10 punonjësish të përbërë nga: Administratori – 1; Administratë (Financë, Jurist etj) – min 1; Inxhinier/Drejtnes Teknik (Mjedisi, Kimist) – min 2; Shoferë – 2; Punetore ngarkim shkarkimi – min 2 (1 për çdo shofer); Punetore të tjera në impiant – min 2. Ndarja e mesipërme nuk është e detyrueshme për tu përmbushur nga OE, por është vlerësuar nga AK thjesht si orientuese për qëllim të përlllogaritjes së numrit total të punonjësve të kërkuar.*

Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij Inxhinier Mjedisi është vendosur në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysh proceset përkatëse të shërbimit lidhur me Tajtimin dhe Evadimin e Mbetjeve Spitalore bazuar në specifikat e këtij shërbimi si dhe duke patur parasysh se ky shërbim ka impakt në mjedis vecanerisht në këto periudhe mjaft të ndjeshme për shëndetin publik për shkak të reziqeve epidemiologjike, është e rëndësishme që të mos tolerohet asnjë cëdim në kapacitetet sa më të sigurta teknike që kërkohet të kenë ofruesit e këtij shërbimi dhe duhet mbajtur parasysh se reputacioni dhe besueshmëria kërkojnë që operatorët e shërbimit të demonstrojnë një nivel të caktuar qëndrueshmërie në drejtim të krijimit dhe ruajtjes së kapaciteteve profesionale.

Gjithashtu për të mos penalizuar asnjë OE të interesuar është kërkuar një kohë minimale punësimi për personelin e punësuar.

2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, apo nepermjet çdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojnë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i këtyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se për miratimin e rregullores “Për menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (*Rregullorja*) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1 dhe impiant back up (zëvendësues) me të njëjtën metodë;
- b. Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1 dhe impiant back up (zëvendësues) me të njëjtën metodë;
- c. Makineri për larjen e kontenierëve cope 1 dhe makineri back up të tillë (vetëm në rastin kur do të përdoren konteniere të ripërdorshëm);

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- a) Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- b) Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
- c) Katalog ose skedë teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;
- d) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e të dhënave konkrete për secilën pajisje (përfshirë edhe ato back up), nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST, duke përfshirë të dhënat si vijon: emërtimi i impiantit / modeli / kodet e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjëson (ato që janë objekt prokurimi) / Leja dhe Licenca përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër

#### **Shenim:**

*Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me orëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa*

vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku përcaktohet se : “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se : “4.Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç ) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.” , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në bazë të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore ne varesi të rrymes se mbetjeve janë kërkuar impiantet baze për realizimin me sukses të ketij shërbimi.

Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera impiantet për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) cope 1 dhe impiant back up me të njëjtën metodë dhe Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1 dhe impiant back up me të njëjtën metodë. Eshtë kërkuar që impiantet të jenë me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) dhe me incenerim në varesi të llojit të mbetjeve. Aktet ligjore dhe nenligjore të mesiperme përcaktojnë se për rryma të ndryshme mbetjesh si ato të përkrahura në objektin e prokurimit, duhen aplikuar metoda të ndryshme trajtimi dhe asgjësimi, për disa duhet përdorur metoda e nxehtësisë (sterilizim/asgjësim) dhe për disa duhet përdoret metoda e incenerimit. Refruar VKM Nr.798, datë 29.9.2010 dhe Udhëzuesi Kombëtar i Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore” a) asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme: Mbetje citotoksike, Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08, Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03),(kodet, 18 01 08, 18 01 02) bëhet në një instalim incenerimi. ndersa trajtimi i mbetjeve që i përkasin rrymave të mbetjeve infektive (18 01 01 dhe 18 01 03) bëhet me metodën e nxehtësisë (autoklavimit).

Impiantet back up (zëvendësues) janë kërkuar duke mbajtur në konsideratë, se impiantet kryesore do jenë në gjendje pune të vazhdueshme, kanë nevojë edhe për periudha mirëmbajtjeje parandaluese ose/dhe korrigjuese, si dhe duke parashikuar që mund të pësojnë difekte të zgjatura në kohë ose edhe të pariparueshme, është vlerësuar e nevojshme që të kërkohet edhe një makineri back up (zëvendësuese), për secilin impiant me të njëjtin kapacitet, në mënyrë që të mos rrezikohet ndërprerja e shërbimit. Kjo edhe sepse, edhe në rast se OE do të zëvendësonte impiantin e difektuar me një të ri, do të merrte sidoqoftë një kohë të gjatë pajisja e tyre me lejet e licencat përkatëse, çka sërish do të shkaktonte ndërprerje të gjata të ketij shërbimi teper sensitiv.

Ky qendrim është mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik në :

- vendimin nr. 443/2023 date 30.05.2023, ku në pikën III.1.30, ku ndër të tjera është shprehur se III.1.30. “Ndërsa lidhur me pretendimin për sa i përket impianteve back up, Komisioni gjykon, se duke marrë shkasë nga natyra, lloji i veçantë i kësaj procedure prokurimi, si dhe ndikimi dhe ndjeshmëria e lartë që ka kjo procedurë, disponueshmëria nga operatorët ekonomikë përveç impianteve kryesore edhe e atyre back up (ose zëvendësues) gjykon, se është një kërkesë e arsyeshme dhe e domosdoshme kjo për vetë faktin se i shërben autoriteti kontraktor si garanci që në rast të ndonjë avarie ose mosfunksionimi të impianteve kryesore operatorët ekonomikë do të vendosin në funksion impiantet back up ose zëvendësues, me qëllim që të sigurohet që ky shërbim do të ofrohet në mënyrë të pandërprerë nga operatorët ekonomikë, e që rrjedhimisht do të sillte edhe realizimin me sukses të këtij shërbimi sensitiv. Pasi një sistem impiantesh reserve back up do të garantonte vazhdueshmërinë e shërbimit në rast defektesh, mirëmbajtjesh, apo raste të një mbingarkese të sasive tej parashikimeve të autoritetit kontraktor....”

dhe

- Vendimi nr.564/2023 date 05.07.2023 ku ne piken III.3.7 ndër të tjera është shprehur se “.....Ndërsa lidhur me pretendimin për impiantet dhe makineritë back up, Komisioni gjykon, se duke marrë shkas nga natyra, lloji i veçantë i kësaj procedure prokurimi, si dhe ndikimi dhe ndjeshmëria e lartë që ka kjo procedurë, disponueshmëria nga operatorët ekonomikë përveç impianteve dhe makinerisë kryesore edhe të atyre back up (ose zëvendësues) gjykon, se është një kërkesë e arsyeshme dhe e domosdoshme, kjo për vetë faktin se i shërben autoritetit kontraktor si garanci, që në rast të ndonjë avarie ose mosfunksionimi të impianteve ose makinerisë kryesore operatorët ekonomikë do të vendosin në funksion impiantet apo makinerinë back up ose zëvendësues, me qëllim që të sigurohet që ky shërbim do të ofrohet në mënyrë të pandërprerë nga operatorët ekonomikë. Kjo rrjedhimisht do të sillte edhe realizimin me sukses të këtij shërbimi sensitiv, pasi një sistem impiantesh dhe makinerish rezerve back up do të garantonte vazhdueshmërinë e shërbimit në rast defektesh, mirëmbajtjesh, apo raste të një mbingarkese të sasive tej parashikimeve të autoritetit kontraktor.....”

Disponimi i impjanteve vertetohet nepermjet dokumentit për vërtetimin e pronësisë, huaperdorjes ose të marrjes me qera apo nepermjet cdo menyre posedimi te njohur nga ligji të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi), eshte lene me alternative pra mund te jete ne pronesi ose me qira (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi) ne menyre qe te rrise pjesmarrjen dhe qe mos te penalizojë asnje OE. Gjithashtu kerkohet katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant ne menyre qe te vertetohet disponueshmeria dhe besueshmeria e ketij impjanti. Afati i marrjes me qera te eshte lene minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi ne menyre qe te mos cenoje ekzekutimin sherbimit

Kërkohet gjithashtu që impiantet të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 (argumentuar tek pikat perkatese 2.1.1 dhe 2.1.2)

Deklarata e Konformitetit CE per secilin impiant eshte kerkuar pasi ne kete periudhe mjaft te ndjeshme per shendetin publik per shkak te rreziqeve epidemiologjike, eshte e rendesishme qe te mos tolerohet asnje cedim ne kapacitetete sa më të sigurta teknike qe kerkohet te kene ofruesit e ketij sherbimi.Vendosja e kësaj kërkesë është në përputhje me ligjin nr.10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i cili rregullon në mënyrë të posacme nevojën e pasjes së Deklaratës së Konformitetit CE, si kusht për vendosjen në treg dhe instalimin e produkteve industrial, vecanerisht impiante që disiplinohen me rregulla teknike të posacme sic janë impiantet që punojnë me lëndë djegëse, me avull, me presion, apo me sisteme elektrike.

Persa i perket makinerise për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm , ne planifikimin e menaxhimit te mbetjeve spitalore, eshte parashikuar që në dallim nga kontenitoret per te mprehtat dhe qeset dhe ato të posacmit për citostatiket, që janë amballazhi i drejtpërdrejtë i mbetjeve spitalore që duhet të jenë njëpërdorimëshe, kontenitoret plastike te medhenj qe duhet te vihen ne dispozicion nga Operatori Ekonomik fitues që shërbejnë për transferimin dhe transportin e mbetjeve spitalore, duhet te jene shumeperdorimesh dhe kjo nuk eshte nje zgjedhje subjektive e AK, por e ndikuar nga shkaqet ligjore, ekonomike dhe mjedisore si vijon:

1. Dispozitat ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe ato per menaxhimin e integruar te mbetjeve kane përcaktuar qartë se parimet dhe hierarkia e menaxhimit te mbetjeve duhet te jete e tillë që të synojë sa më shumë të jetë e mundur parandalimin, ripërdorimin, riciklimin, etj, dhe të pranojë asgjësimin vetëm si alternativë të fundit. Më konkretisht:

Ligji nr. 10 463, date 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në nenin 6 ka përcaktuar që: "1.Përcaktimi i përparësive në ligje, strategji, plane dhe programe të menaxhimit të integruar të mbetjeve të trashëguara apo të atyre që krijohen bëhet duke pasur parasysh hierarkinë e mëposhtme: a) parandalimin e mbetjeve; b) përgatitjen për ripërdorim; c) riciklimin; ç) rikuperime të tjera; d) asgjësimin. 2.Për përcaktimin e kësaj hierarkie mbahen parasysh parimet e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në nenet 6-14 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe kërkesat e tjera të këtij ligji. 3.Në rastet e zbatimit të hierarkisë së menaxhimit të integruar të mbetjeve, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ministria dhe të gjitha autoritetet perkatëse marrin masa për të nxitur opsionet me rezultatet e përgjithshme më të mirat në mjedis. 4.Aktet nënligjore të veçanta për rryma të veçanta mbetjesh bazohen në hierarkinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kur një gjë e tillë justifikohet nga analiza e ciklit të kohëzgjatjes së ndikimeve të përgjithshme, që vijnë nga krijimi dhe menaxhimi i këtyre mbetjeve, në mënyrë që të përftohet rezultati i përgjithshëm më i mirë për mjedisin."

Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” përcakton sa vijon:

Neni 7 pg.1 "Masat për mbrojtjen e mjedisit merren në një fazë të hershme të zhvillimit të çdo veprimtarie, në mënyrë që të parandalojnë apo, në rast se nuk është e mundur, të minimizojnë efektet negative të asaj veprimtarie në mjedis."

Neni 33 pg.1 "Menaxhimi i integruar i mbetjeve synon parandalimin ose reduktimin e mbetjeve dhe ndikimeve të dëmshme të tyre mbi mjedisin, si dhe përdorimin e efektshëm të burimeve natyrore, me qëllim mbrojtjen e mjedisit, të burimeve, të shëndetit të njeriut, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës."

Kërkesat për parandalimin e krijimit të mbetjeve dhe minimizimin e tyre janë përcaktuar në mënyrë specifike edhe në Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore i nxjerrë në zbatim të VKM Nr. 798, date 29.09.2010, në të cilin përcaktohet sa vijon:

Në pikën 1.2 (faqe 5) - Parimet e administrimit të mbetjeve:

Parimet e mira të administrimit të mbetjeve përfshijnë:

- minimizim i prodhimit të mbetjeve
- rregullim i ndarjes së mbetjeve në burim sipas të cilit mbetjet e destinuar për mënyra të
- ndryshme trajtimi dhe asgjësimi ndahen në "rryma" të ndryshme;
- udhëzim dhe trajnim i personelit lidhur me rregullimin e ndarjes së mbetjeve në burim dhe
- motivimi i tyre për të siguruar se ndarja është efektive;
- organizim i trajtimit dhe i asgjësimit të mbetjeve në mënyrën e duhur për çdo rrymë;
- mbajtje e regjistrave;
- monitorim i performancës së organizimit të ndarjes në burim dhe asgjësimit;
- marrje e masave korigjuese nëse është e nevojshme.

Pra, në planifikimin e menaxhimit të mbetjeve spitalore, duke kërkuar konteniere plastike që mund të ripërdoren, ka zbatuar pikërisht parimin e "minimizimit të prodhimit të mbetjeve", pasi nëse do të pranonte konteniere njëpërdorimësh që duhet të asgjësohen pas çdo përdorimi së bashku me mbetjet spitalore, do të shtonte me shumëfisha volumin e mbetjeve që shkojnë për asgjësim, dhe kjo do të ishte në kundërshtim me të gjitha parimet e sipërcituara.

Në pikën 8.2.2 (faqe 25 - 26) të Udhëzuesit së bashku me foton ilustruese - Karrocet e përdorura për transferimin e mbetjeve spitalore:

Për transferimin e mbetjeve spitalore në godina, duhet të përdoren karroca të caktuara për këtë funksion. Ato duhet të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me specifikimet e mëposhtme:

- Sipërfaqet duhet të jenë të buta, pa tehe të mprehta ose të ashpra (që mund të dëmtojnë ambalazhin e mbetjeve spitalore);
- Duhet të përdoren materiale të papërshkueshme dhe projektimi duhet të sigurojë kontrollin e çdo derdhje të mbetjeve që mund të ndodhë në tranzit;
- Karrocet duhet të jenë të tilla që të pastrohen dhe kullohen lehtë, dhe
- Modelimi i përgjithshëm duhet të lejojë që qeset dhe kontenierët të mbahen siç duhet në karroca, dhe të ngarkohen/shkarkohen në mënyrë të sigurtë dhe manipulohen pavështirësi. Karrocet duhet të pastrohen në fund të çdo dite pune dhe të dezinfektohen tërësisht në intervale të rregullta.



Foto 10. Idealisht, mbetjet duhet të transportohen në konteniere prej plastike të durueshme dhe me rrota

Në pikën 9.1 (faqe 28 - 29) të Udhëzuesit - Shërbimi i grumbullimit

Grumbullimi i mbetjeve spitalore duhet të kryhet nga subjekt i licencuar në përputhje me kërkesat e specifikuara në licencat për grumbullimin e mbetjeve dhe në përputhje të plotë me Rregulloren.

Koshat/kontenierët tranzit të specifikuar në seksionin 9.3.1 të këtij Udhëzuesi duhet të përdoren për grumbullimin e mbetjeve spitalore nga prodhuesit e mbetjeve.

Grumbulluesit e licencuar duhet të kontrollojnë dhe sigurojnë ambalazhimin, mbylljen dhe etiketimin e duhur të kontenierëve të mbetjeve në lidhje me kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë Udhëzues para vendosjes së tyre në koshat/kontenierët tranzit. Mbetjet spitalore si indet njerëzore dhe ato shtazore duhet të vendosen në kosha/kontenierët tranzit për këtë qëllim, pa i përzier me mbetjet e tjera spitalore. Nëse mbetjet spitalore janë vendosur në koshat/kontenierët tranzit që gjatë magazinimit nga prodhuesit e mbetjeve, grumbulluesit e licencuar duhet që para grumbullimit të koshave/kontenierëve tranzit, të sigurohen se ata janë të mbyllur mirë dhe etiketuar siç duhet, sipas seksionit 9.3.1 të këtij Udhëzuesi.

Në pikën 9.3.1 (faqe 29 - 30) të Udhëzuesit - Koshat/kontenierët tranzit

Çdo kosh/kontenier për mbetjet spitalore përveç atyre që kërkojnë ruajtje në frigorifer duhet të ketë shënimin "MBETJEVE SPITALORE" në Shqip" dhe HEALTHCARE WASTE" në Anglisht, me lartësi minimale prej 40 mm dhe në ngjyrë të ZEZË, ndërsa për mbetjet spitalore që kërkojnë ruajtje në frigorifer duhet të ketë shënimin "MBETJEVE

SPITALORE PER FRIGORIFER " në Shqip dhe "HEALTHCARE WASTE FOR REFRIGERATION" në Anglisht, si dhe shenjë ndërkombëtare të bio-hazardit e dhënë në Shtojcën G me një lartësi minimale prej 240 mm në ngjyrë të ZEZË. Koshat/kontenierët tranzit për indet njerëzore dhe shtazore duhet të jetë në ngjyrë të VERDHË ose të ketë një etiketë të dallueshme në të VERDHË për të lehtësuar identifikimin e mbetjeve. Çdo kosh/kontenier duhet të ketë një numër serial unik që duhet të shfaqet në shifra të dallueshme në ngjyrë të ZEZË dhe/ose germa për identifikim të lehtë dhe për qëllim regjistrimi.

Koshat/kontenierët tranzit duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Të shërbejnë vetëm për qëllim të ruajtjes së mbetjeve spitalore të paketuara;
- Të jenë të pajisur me kapak dhe të mbyllën shumë mirë;
- Të mos lejojnë derdhjen e përmbajtjes dhe depërtimin e shiut përmes kapakut apo mbulesës;
- Të mos lejojnë strehimin e insekteve dhe parazitëve dhe grumbullimin e mbetjeve spitalore në anët apo në çarjet, etj;
- Të jenë të tipit për shumë-udhëtime dhe të ripërdorueshëm; dhe
- Të mund të dezinfektohen ose dekontaminohen me avull.

Gjithashtu, në pikën 3 "Koshat plastikë" të Shtojcës E "Specifikimet për kontenierët e mbetjeve spitalore" të Udhëzuesit, ndër të tjera është përcaktuar që: "Këta kontenierë duhet të inspektohen pas çdo përdorimi për të siguruar që janë të pastër, të padëmtuar dhe pa rrjedhje. Çdo kontenier i dëmtuar duhet të riparohet para se të përdoret ose të hiqet nga përdorimi. Pjesa e brendshme duhet të jetë e lëmuar dhe e papërshkueshme që të mbajë ndonjë derdhje dhe që të mund të inspektohen, pastrohen dhe higjienizohen lehtësisht."

Nga përcaktimet e mësipërme, është e qartë se kërkesa e AK për kontenierë plastikë shumëpërdorimësh është jo vetëm e logjikshme, por edhe e mbështetur në dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Përdorimi i konteniereve plastike njëpërdorimesh do të ishte gjithashtu në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara dhe do të ishte promovim i rritjes së ndotjes së mjedisit.

Në rrethanat e mësipërme, është plotësisht e argumentuar vendosja e kërkesës që OE të disponojnë makineri për larjen e kontenierëve. Gjithashtu, është e bazuar edhe kërkesa që kjo të jetë e përfshirë në lejen mjedisore, pasi është detyrim që aktiviteti i "larjes dhe pastrimit të kontenierëve që mund të ripërdoren" të pajiset me leje mjedisore, qofte Leje Mjedisore të Tipit A (kod III.1.C) ose të tipit B (III.1.B).

Pra, pastrimi, larja, madje edhe dizinfektimi i konteniereve në mënyrë që të ripërdoren është jo vetëm pjesë e elementëve të shërbimit që OE duhet të ofrojnë, por është edhe përcaktim i dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi që kontenierët duhet të ripërdoren dhe për këtë qëllim duhet të pastrohen e lahen pas çdo përdorimi.

Disponimi i makinerive vërtetohet nepermjet dokumentit për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera apo nepermjet çdo menyre posedimi të njohur nga ligji të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi), është lene me alternative pra mund të jete ne pronesi ose me qira (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi) ne menyre qe te rrise pjesmarrjen dhe qe mos te penalizojë asnje OE. Gjithashtu kerkohet katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i makinerise ne menyre qe te vërtetohet disponueshmeria dhe besueshmeria e kesaj makinerie. Afati i marrjes me qera te eshte lene minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi ne menyre qe te mos cenoje ekzekutimin shërbimit

Kërkohet gjithashtu që makineria të jetë e pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 (argumentuar tek pikat përkatëse 2.1.1 dhe 2.1.2)

Deklarata e Konformitetit CE për makinerite është kërkuar pasi në këte periudhë mjaft të ndjeshme për shëndetin publik për shkak të rreziqeve epidemiologjike, është e rëndësishme që të mos tolerohet asnjë cënim në kapacitetet sa më të sigurta teknike që kërkohej të këne ofruesit e këtij shërbimi. Vendosja e kësaj kërkesë është në përputhje me ligjin nr.10 489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i cili rregullon në mënyrë të posacme nevojën e pasjes së Deklaratës së Konformitetit CE, si kusht për vendosjen në treg dhe instalimin e produkteve industrial, vecanërisht impiante që disiplinohen me rregulla teknike të posacme sic është dhe rasti aktual.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi i mbetjeve, e cila duhet të jete aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:



- Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi brenda afatit të vlefshmerisë,

**Argumentimi:** Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku përcaktohet se : “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike.....” dhe dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se : “4.Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç ) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”, në VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, si dhe duke qene se ne baze te VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, strukturat spitalore si krijues të mbetjeve jane pergjegjes deri ne hallken e fundit te asgjesimit te mbetjeve spitalore qe krijojnë, AK kërkon që operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të lidhur me subjekt të autorizuar sipas ligjit për depozitimin e produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/asgjësimi, e cila duhet të jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave.

Ky kriter është në përputhje me Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 798, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore" i cili përcakton sa vijon: " 4. Roli i organeve shtetërore a) Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Shëndetësisë hartojnë standardet e administrimit të mbetjeve spitalore. b) Ministria e Shëndetësisë siguron kushte për aplikimin e standardeve të administrimit të mbetjeve spitalore."

"5. Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për: a) grumbullimin e kontrolluar të mbetjeve spitalore pranë institucionit shëndetësor; b) ndarjen e mbetjeve spitalore të parrezikshme (të llojit urban) nga mbetjet spitalore të rrezikshme; c) ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe asgjësimin në mënyrë të përshtatshme, të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre; d) shpenzimet e transportit, asgjësimi ose riciklimit të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre. Kjo përgjegjësi është e pashmangshme dhe e pavarur nga përgjegjësia e ndonjë personi të tretë të ngarkuar nga prodhuesi, për të ndërmarrë këto veprimtari; e) të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimi të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre." "8. Çdo prodhues i mbetjeve spitalore është përgjegjës për trajtimin e mbetjeve që nga prodhimi, grumbullimi, ndarja, transporti, magazinimi, përpunimi dhe deri tek asgjësimi i tyre."

Ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në nenin 21 i cili përcakton sa vijon: "1.Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari a personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”. 2. Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve, që transferon mbetjet te një tregtar ose person që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, nuk çlirohet nga përgjegjësia për operacionet e rikuperimit ose të asgjësimi të tyre."

Keto dokumente kerkohen me qellim realizimin me sukses te asgjesimit final te mbetjeve si element mjaft i rendesishem i procesit ku dokumentohet qe OE eshte ne kete fushe aktiviteti dhe e kryen realisht kete lloj sherbimi. Ky kriter eshte mèse i domosdoshem dhe gjithashtu do te kerkohet ne vazhdimesi si pjese e monitorimit te zbatimit te kontrates duke patur parasysh abuzimet e ndryshme te cilat i behen këtij procesi shpesh here te raportuar si nga institucionet e monitorimit (inspektoriatet) dhe të auditimit (Ministria e Shendetesise, Ministria e Mjedisit dhe KLSH) si dhe në media është ngritur problemi i mangësive ndër vite të operatorëve të veçante që veprojnë në fushën e administrimit të mbetjeve spitalore, në vecanti në lidhje me shkarkimin e kundraligjshem në natyre të mbetjeve spitalore, apo të produkteve që derivojnë nga trajtimi i tyre.

Per kete qellim, nje nga kushtet qe vendosen gjithmone ne Lejet e Mjedisit qe leshohen per kete qellim eshte edhe qe OE te depozitohen produktet qe dalin nga trajtimi/perpunimi i mbetjeve spitalore vetem ne landfille/vend-depozitime te licencuara per kete qellim.

Besueshmeria, reputacioni dhe rregullshmeria e nje operatori ekonomik qe operon ne kete fushe, provohet pandashmerisht edhe nga marredhenia e qendrushme dhe e sigurte qe ka nje OE me nje landfill te licencuar per depozitimin e produktit final qe deln nga perpunimi/trajtimi i mbetjeve spitalore, pasi kjo marredhenie eshte kusht thelbesor i operimit ne vijimesi te nje OE qe operon ne kete fushe, per sa kohe edhe depozitimi i produktit final eshte pjese e zinxhirit te asgjesimit te mbetjeve spitalore dhe jo nje operacion ad-hoc apo fakultativ.

Per kete arsye, duke qene se AK eshte prodhuesi i mbetjeve dhe ka pergjegjesi direkte per menaxhimin ne perputhje me ligjin nga operatoret private tek te cilet e kontraktoren kete sherbim, ka edhe pergjegjesine te sigurohet qe cdo OE konkurues i ka te gjitha kapacitetet minimale per te operuar normalisht dhe ne perputhje me ligjet e aktet normative.

Mospasja e nje marredhenie te tille vijuese e te qendrueshme me nje landfill te licencuar, eshte nje tregues se nje OE eshte sporadik ne aktivitetin e vet dhe nuk i jep asnje garanci AK qe kjo mund te realizohet pas lidhjes se kontrates, cka ne rastin me te mire mund te coje ne deshtim te kontrates nese OE e raporton pamundesine per te kontraktuar me nje landfill te licensuar, dhe ne rastin me te keq, nese kjo pamundesi nuk raportohet fare nga OE, mund te shpjegohet ne dem mjedisor (pra shkarkim te produktit te mbetjeve ne menyre te pakontrolluar ne natyre) cka do te ngarkonte me pergjegjesi edhe AK si prodhues i mbetjeve.

Ne kete kontekst kontrata vijuese me landfillin nuk eshte ne vetvete nje kerkese qe lidhet vetem me momentin pas lidhjes se kontrates, por i perket besueshmërise, kapaciteteve teknike dhe organizative qe OE duhet te deshmojne ne kuptim te nenit 77 te LPP, pasi nje OE qe nuk ka nje kontrate ekzistuese dhe vijuese me nje landfill te licensuar, nuk arrin te tregojë se me cfare standartesh dhe perputhshmerie ligjore e kryen aktivitetin e vet ne vijimesi. Pra ky kriter eshte vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qellim besueshmerine e te gjithe procesit te menaxhimit e mbetjeve spitalore duke filluar nga trajtimi i tyre dhe deri ne depozitim e produktit respektiv që del nga proceset e trajtimit/asgjесimit. Gjithashtu eshte kerkuar qe landfilli I licensuar per arsye se landfillimi i mbetjeve eshte nje proces i cili ka ndikim ne mjedis dhe si i tille i nenshtrohet Vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl/qkb) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” me gjithë ndryshimet. Ne kete vendim kjo veprimtari perfshihet ne kategorine III.2.B “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjесim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.7. Operatori duhet te furnizojë kontenitorët sipas standarteve dhe kërkesave të Specifikimeve Teknike dhe Termave te References. Per te provuar plotesimin e ketij kriteri operatori duhet te paraqese per **secilin lloj kontenitori**:

- Katalog ose skede teknike

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku përcaktohet se : “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie ” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se : “4.Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç ) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. ”, Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore i nxjerrë në zbatim të VKM Nr. 798, date 29.09.2010 kontenitorët e mbetjeve spitalore jane elemente te domosdoshem ne proceset e menaxhimit te evadimit te mbetjeve spitalore si per mbledhjen, izolimin, grumbullimin, dhe transportimin e tyre. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE TERMAT E REFERENCES PER PROCEDUREN " EVADIMI, TRAJTIMI I MBETJEVE SPITALORE"**

### **Shtojca 6.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE:**

Per realizimin e shërbimit për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore, bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi, operatori ekonomik duhet të sigurojë:

**Furnizimin me bazen materiale të nevojshme për realizimin e ndarjes në burim dhe magazinimin provizor të mbetjeve spitalore deri në terheqjen e tyre, sipas kërkesave për secilin kod të mbetjeve spitalore.**

Për këtë qëllim, Operatori Ekonomik duhet të vërë në dispozicion të AK, konteniere plastike, qese plastike, kuti për të mprehtat, kuti kartoni (njëpërdorimshëm) për përmbushjen e ambalazhimit referuar tipologjive të mbetjeve. Baza materiale duhet të jetë sipas standardeve dhe kërkesave të VKM nr. 798 date 29.09.2010 "Për administrimin e mbetjeve spitalore", të Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore si dhe të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Kompania duhet të realizojë një furnizim të përshtatshëm në çdo kohë me materiale ndihmëse të nevojshme për grumbullimin e perkohshëm të mbetjeve.

I. Materialet ndihmëse duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

### **Kuti për të mprehtat (brenda diapazonit 3 – 12 Litra)**

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent) "Mbrotjtja nga dëmtimi prej objekteve të mprehta - Kërkesat dhe metodat e testimit - Kontenierët (enët) e objekteve të mprehta".
- Hapja të jetë aq e gjerë sa të lejojë që mbetjet spitalore të hidhen në kuti duke vepruar vetëm me një dorë. Në varësi nga masa e mbetjes spitalore për të cilën është projektuar kutia për të mprehtat, hapja në kushte normale të përdorimit, të pengojë daljen/nxjerrjen e përmbajtjes;
- Nëse janë të pajisur me kapakë të lëvizshëm, të jenë të projektuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e nevojshme shtyrja me dorë e materialeve në kuti;
- Të jenë të tilla që të mbyllën në mënyrë të sigurt dhe të mbeten të mbyllura gjatë transportit;
- Pasi janë mbyllur, të gjithë llojet e kutive për të mprehtat të mos lejojnë rrjedhje;
- Të jenë të pajisura me dorezë që nuk është pjesë e pajisjes mbyllëse;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropilene);

- Të jetë e shënuar në mënyrë të dukshme me një vijë horizontale për të treguar kur kutia e të mprehtave është e mbushur ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të saj maksimal, së bashku me fjalët "KUJDES - MOS E MBUSHNI MBI VIJË";
- Të jenë me ngjyrë të verdhë apo kombinim i të bardhës dhe të verdhës; dhe për të mprehtat e ndotura nga citotoksikë, me kapak ngjyrë të kuq ose të purpurt me simbolin e mbetjeve citotoksike;
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa. ku të lexohen qartë fjalët "RREZIK: TË MPREHTA TË NDOTURA" dhe të përmbajnë simbolin e biohazardit në etiketë.

#### **Koshat plastikë (brenda diapazonit 40 – 60 Litra)**

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent)
- Të tillë që të mbyllën në mënyrë të sigurtë;
- Rezistent ndaj rrjedhjes, thyerjes nga goditja dhe shpimet;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropilene);
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa perkatese sipas pikes II të këtyre Specifikimeve "ETIKETAT".

*Shënim: Në rastin e koshave plastikë shumëpërdorimësh, duhet të garantohet larja dhe dezinfektimi i tyre në makinerinë përkatëse të specializuar*

#### **Kuti kartoni njëpërdorimshe (40 - 60 litra)**

- Të jenë të shoqëruara me qese që vendoset në pjesën e brendshme.
- Të jenë ekologjike (që nuk lëshojnë substanca gjatë djegjes)
- Të jenë të palosshme për të zënë pak hapësirë në ruajtje, të lehta për t'u shpalosur dhe mbyllur, me mbajtëse anësore të shtangëta dhe të qëndrueshme.

#### **Qeset plastike**

Janë qese plastike për grumbullimin dhe ruajtjen e mbetjeve spitalore dhe mbetjet e lidhura me to, përveç mbetjeve të mprehta.

- Të kenë rezistencë të mjaftueshme për të mbajtur në mënyrë të sigurtë klasën e mbetjeve për të cilat ato janë caktuar;
- Me një kapacitet maksimal nominal prej 0.1 m<sup>3</sup>;
- Me trashësi minimale prej 150 mikron nëse janë prodhuar nga polietilen me dendësi të ulët, ose 75 mikron nëse janë prodhuar nga polietilen me dendësi të lartë ose polipropilene dhe nuk duhet të prodhohen nga polivinilkloridi (PVC);
- Të përmasave dhe formës së përshtatshme për t'ju përshtatur mbajtësve të qeseve në përdorim;
- Të jetë e shënuar në mënyrë të dukshme me një vijë horizontale për të treguar kur kutia e të mprehtave është e mbushur ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të saj maksimal, së bashku me fjalët "KUJDES - MOS E MBUSHNI MBI VIJË";
- Nuk duhet që të sigurohet me kapse ose me pajisje të tjera mbyllëse me dalje të mprehtë.
- Me ngjyra të verdhë për mbetjet spitalore;

E tillë që në të mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa. Etiketimi duhet të jetë në përputhje me Shtojcën F.

## **II. ETIKETIMI**

Çdo enë e mbetjeve spitalore duhet të ketë në pjesën e jashtme të saj një etiketë e cila të përmbajë shenjën ndërkombëtare të Biohazardit sipas modelit me përmasat e specifikuar në më poshtë:

Etiketa të prodhohet me material që u reziston rrezeve UV, ujit dhe të jetë ngjitëse, ose të jetë e stampuar një pozicion të dallueshëm të enës që lejon që të dhënat në etiketë të lexohen lehtë.

## PËRMASAT E SIMBOLIT

### Tipi i kontenierit të mbetjeve spitalore

### Përmasat e simbolit

#### Tipi i kontenierit

#### Përmasat e etiketës

Kontenier për të mprehtat  
me kapacitet prej më pak se 2 litra

jo më pak se 40 mm x 40 mm

Kontenier për të mprehtat  
me kapacitet prej 2 litra ose më shumë  
Kontenierë të tjerë

jo më pak se 75 mm x 75 mm

jo më pak se 150 mm x 150 mm



### Specifikimet e simbolit:

Ngjyrat e simbolit të jenë si më poshtë:

Konturet – ngjyrë e zezë

Fusha – ngjyrë e bardhë ose ngjyra parësore e enës

Fjalët dhe karakteret – ngjyrë e zezë

Shenja ndërkombëtare e Biohazardit – ngjyrë e zezë

## PËRMBAJTJA E ETIKETËS

Çdo kontenier i mbetjeve spitalore, pasi mbyllet dhe vuloset, të identifikohet me një etiketë që të vendoset në pjesën e përparme të kontenierit dhe që të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- i. Identifikimin: Mbetje Spitalore
- ii. përcaktimin: “Infektuese”
- iii. fjalën sinjalizuese: Rrezik
- iv. njoftimin e rrezikshmërisë: “Mund të shkaktojë infeksion”
- v. Kodin sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve: 18. ... ..
- vi. Gjendjen: e ngurtë ose të lëngët;
- vii. Datën e fillimit dhe përfundimit të grumbullimit;
- viii. Sasinë në kg ose litra;
- ix. Prodhuesin / Kodin Unik / Adresën / Personin përgjegjës (Emër/mbiemër/firmë / nr.telefoni)

### PER ORIENTIM-MODEL ETIKETE:

<b>MBETJE SPITALORE</b>		<b>Infektuese</b>
<b>RREZIK! Mund të shkaktojë infeksion</b>		
RRYMA E MBETJEVE: IE. ... .. (sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve)		
GIJENDJA: NGURTE	<input type="checkbox"/>	
LËNGSHME	<input type="checkbox"/>	
GRUMBULLIMI I MBETJEVE:		
DATA E FILLIMIT: ... / ... / 20 ...		
DATA E PËRFUNDIMIT: ... / ... / 20 ...		
SASIA: ..... (.....) (kg ose l)		
PRODHUESI: .....		
KODI UNIK: .....		
ADRESA: .....		
PERSONI PËRQJESËS: (emër/mbiemër/firmë) .....		
Nr. Telefoni: .....		

### Etiketat për vendin e magazinimit të AK

Kontraktori duhet të sigurojë për AK etiketat që duhet të vendosen dukshëm si shenja e rrezikut në dyer, porta ose mbulesa, sipas modelit të mëposhtëm:

<p><b>KUJDES!</b></p> <p><b>MBETJE SPITALORE</b></p>	
<b>Specifikimet</b>	
1. Materiali:	I durueshëm, rezistent ndaj faktorëve atmosferikë, i padeformueshëm kur vendoset në pozicionin vertikal
2. Ngjyrat:	Sfondi i verdhë Shenja e Biohazardit e zejë Germat të zeza
3. Përmasat:	Pllaka lartësia ≥ 500 mm Shenja e biohazardit gjatësia ≥ 600 mm Germat lartësia ≥ 150 mm lartësia ≥ 40 mm

### III. Terheqja e mbetjeve nga vendgrumbullimi dhe transportin deri ne vend trajtim.

Operatori ekonomik duhet te siguroje grumbullimin e konteniereve me mbetje ne pikat e perkohshme te magazinimit prane AK si dhe transportin e tyre ne impiantin e trajtimit me mjetet e posacme te transportit.

Njekoheisht me grumbullimin e konteniereve duhet te vihen ne dispozicion konteniere te rinj te gatshem per tu perdorur.

Transporti i konteniereve duhet te kryhet ne menyre qe te sigurohet integriteti dhe pastertia e tyre, ne perputhje me rregullat e higjenes dhe sigurise.

Automjetet e perdorura per transportin e mbetjeve spitalore duhet te kenë karakteristikat e mëposhtme:

**Specifikimet për panelin paralajmërues të rrezikut për automjetet e grumbullimit të mbetjeve spitalore**

Një nga dy variantet (Varianti A dhe Varianti B) të panelit paralajmërues të rrezikut siç tregohet në figurën e mëposhtme duhet të shfaqet në pjesën e përparme dhe të pasme të automjetit të grumbullimit të mbetjeve spitalore në një pozicion që nuk mbulon asnjë dritë, targën ose shenime apo shenja të tjera të kërkuara ligjërisht. Të dy versionet janë të pranueshme dhe zgjedhja varet kryesisht nga hapësira në dispozicion për shenjën.

#### Specifikimet:

- **Materiali** : pjatë alumini (1-2 mm e trashë)
- **Veshja**: sfond reflektues
- **Ngjyrat** : konturi – i zi  
sfondi – i verdhë  
fjalët dhe karakteret – të zeza
- **Përmasat** : fjalët dhe karakteret  $\geq 40$  mm në lartësi  
pjata (Versioni A): gjatësia  $\geq 200$  mm; gjerësia  $\geq 750$  mm  
pjata (Versioni B): gjatësia  $\geq 340$  mm; gjerësia  $\geq 500$  mm

#### Versioni A

**CAUTION: HEALTHCARE WASTE**  
**KUJDES: MBETJE SPITALORE**

#### Versioni B

**CAUTION:**  
**CLINICAL WASTE**  
  
**KUJDES:**  
**MBETJE SPITALORE**

1. Të sigurojë kontakt minimal të njeriut me kontenierët e mbetjeve spitalore gjatë ngarkim-shkarkimit të tyre.
2. Të ketë një ndarje midis kabinës së shoferit dhe trupit të automjetit.
3. Të ketë një sistem të përshtatshëm për sigurimin e ngarkesës gjatë transportit.
4. Të mbahet i kyçur përveç kur ngarkohet dhe shkarkohet.
5. Të jetë projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos lejojë derdhjet e mbetjeve të ngurta dhe të lëngta

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të realizojë ngarkimin dhe shkarkimin e koshave/kontenierëve në dhe nga makina e grumbullimit. Personeli i trajnuar dhe caktuar për këto qëllime duhet të përdorë veshje të përshtatshme mbrojtëse si doreza, çizme, përparëse dhe maskat.

#### IV. Dezinfectimin

Operatori Ekonomik duhet të realizojë dezinfectimin:

- Kontenierëve për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve spitalore duhet të dezinfectohen para dhe pas çdo terheqje.
- Mjediseve për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve të caktuara nga AK ku realizohet terheqja e kontenierëve, të cilët duhet të dezinfectohen në intervale të rregullta.

## V. Trajtimin e mbetjeve spitalore dhe asgjesisimin final te produkteve te trajtimit, sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi

Kontraktori, në cilësinë e marrësit të mbetjeve spitalore duhet të jetë i pajisur gjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit me Licencë III 2 B, Leje të Mjedisit të tipit A dhe/ose B sipas kategorise se mbetjeve dhe Akt-Miratim Higjiemo-Sanitar, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Trajtimi i mbetjeve spitalore kryhet nga subjektet e licencuar, në impiantet për trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, që duhet të jenë të licensuar dhe të respektojnë kërkesat sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat.

Pajisja me leje mjedisore dhe licensë përkatëse e operatorëve ekonomik dhe impianteve për trajtimin e mbetjeve është kusht për kualifikimin. Lejet Mjedisore përkatëse duhet të përmbajnë të dhëna të detajuara që identifikojnë qartë: metodën e trajtimit, teknologjinë e impianteve, llojin dhe tipin e impiantit, vendndodhjen, kapacitetet, ciklet dhe proceset e punës së impianteve.

A. Trajtimi i mbetjeve spitalore të kryhet me metoda të standartizuara. Proceset bazë për trajtimin e mbetjeve spitalore janë si vijon:

- ✓ termik: ky proces përdor energjinë termike për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- ✓ kimik: ky proces përdor dezinfektantë si dioksid klori i tretur, hipoklorit natriumi, acid peracetik, solucion gëlqereje, gaz ozoni ose kimikate të thata inorganike (p.sh. pluhur oksid kalciumi) për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- ✓ mekanik: ky proces përfshin copëtimin, bluarjen, përzierjen dhe ngjeshjen me qëllim përmirësimin e shkallës së transferimit të nxehtësisë, depërtimit të avullit dhe kontaktit me dezinfektantin kimik si dhe për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve, për t'i bërë mbetjet e trajtuara të panjohshme ose për të shmangur dëmtimin fizik në rastin e mbetjeve të mprehta të trajtuara. Ky proces nuk mund të shkatërrojë patogjenët, por plotëson proceset e tjera të trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme.

B. Llojet e pranueshme të teknologjive për trajtimin e mbetjeve spitalore

a. Teknologjitë termike pa djegie

- Autoklavat – trajtimi kryhet përmes nxehtësisë së mbetjeve nga avulli nën presion.
- Sistemet e integruara (ose autoklava të avancuara apo autoklava hibride) - kombinojnë trajtimin me avull me procese të tjera mekanike si ngjeshje, copëtim, grirje, para, gjatë ose pas trajtimit;
- Trajtimi me nxehtësinë e fërkimit - përdor nxehtësinë e fërkimit të plotësuar nga ngrohësit me rezistencë për të nxehur mbeturinat, ndërkohë mbetjet coptohen në kokrriza të thata.
- Sistemet e nxehtësisë së thatë – nxehtësia aplikohet pa shtuar avull ose ujë. Mbetjet nxehen nëpërmjet përçimit, konveksionit natyror ose të detyruar dhe/ose rrezatimit termik.

b. Teknologjitë kimike

- Hidroliza alkaline - shndërron mbetjet patologjike në një tretësirë ujore të dekontaminuar.

c. Teknologjitë me djegie

- i. Inceneratorët – trajtimi bazohet në procesin e oksidimit të thatë dhe temperaturës së lartë që kthen mbetjet organike dhe të djegshme në lëndë inorganike dhe të padjegshme dhe që rezulton në një reduktim të ndjeshëm të vëllimit dhe peshës së mbetjeve”.



C. Per procesin e trajtimit te mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron në një regjistër të posacëm, minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- a. numrin e identifikimit të ciklit të trajtimit;
- b. sasinë ditore, llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;
- c. datën, orën e fillimit dhe mbarimit të ciklit të trajtimit;
- d. temperaturën dhe presionin;
- e. subjektin/vend-depozitimin ku dorëzon për asgjësim tepricat e krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të asgjësuesit të këtyre tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara;
- f. Të dhenat për lejen e mjedisit A dhe/ose B, të licencës III.2.B dhe Kodin Unik të asgjësuesit të tepricave të mbetjeve spitalore;

D. Asgjesimi i tepricave që rezultojnë nga trajtimi i mbetjeve spitalore

Kontraktori është përgjegjës për tu siguruar për evadimin përfundimtar me asgjesim të tepricave që rezultojnë pas trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Procesi i asgjesimit të tepricave, mund të realizohet nga vetë Kontraktori, nëse është i pajisur me Leje Mjedisore dhe Licensën përkatëse për këtë proces, ose nga subjekte të tjera të pajisur me Leje Mjedisore e Licensë përkatëse, me të cilët Kontraktori duhet të ketë kontratë aktive ne momentin e dorezimit te ofertave dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Kuadër do te jete pergjegjes qe te mundesoje qe ky sherbim te vazhdoje sipas standarteve dhe rregullave ne fuqi.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë të sterilizuara:

- a) mund të dërgohen për rikuperim në impiantet termike të prodhimit të energjisë;
- b) mund të asgjësohen në impiantet e djegies së mbetjeve urbane ose në impiantet speciale të djegies së mbetjeve;
- c) nëse nuk ka impiante sipas germës a) dhe b), mund asgjësohen në landfille për mbetjet jo të rrezikshme.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë HI

Hiri nga incineratori dhe tepricat e tjera të ngurta të prodhuara, depozitohen në landfille për mbetje jo të rrezikshme, nëse testet vërtetojnë se nuk paraqesin rrezik sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për mbetjet. Në të kundërt, trajtohen si mbetje të rrezikshme dhe mund të depozitohen në landfille për mbetje të rrezikshme, ose të magazinohen nga Kontraktori deri sa të kontraktojë landfillin e mbetjeve të rrezikshme, ose në pamundësi të disponueshmërisë së një landfilli të mbetjeve të rrezikshme, të realizojë procedurat e nevojshme për eksportin e tyre, dhe ti dokumentojë procesin.

Autoriteti Kontraktor për procesin e asgjësimit të tepricave të mbetjeve spitalore, kur asgjësuesi i tyre është i ndryshëm nga Kontraktori, dokumenton dhe regjistrohen në një regjistër minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- a. Të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të dorëzuesit të mbetjeve spitalore;
- b. Llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;
- c. Sasinë e dorëzuar të tepricave të mbetjeve (në kg);
- d. Datën e dorëzimit;
- e. Numrin e lejes së mjedisit, numrin e licencës III.2.B dhe Kodin unik të dorëzuesit të tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara të dorëzuara për asgjësim;

Në çdo rast të sipërpërmendur mbahet parasysh parashikimi i nenit 44, të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, për të përjashtuar nga depozitimi në landfill mbetjet spitalore të patrajtuara fillimisht në impiante të trajtimit të mbetjeve spitalore.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## Shtojca 7.

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

**Shërbimi që kërkohet: "Evadimi, trajtimi i mbetjeve spitalore" (Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomikë - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj)**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i shërbimit</b>	<b>Kodi i rrymes së mbetjeve</b>	<b>Sasia (kg) e pritshme per 36 muaj</b>
1.	Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)	18 01 01	≈ 12000
2.	Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)	18 01 02	≈ 6000
3.	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet	18 01 03*	≈ 93000
4.	Medikamente citostatike dhe citotoksike	18 01 08*	≈ 4500
			<b>Totali : 115 500 kg</b>

**\*Sasitë e pritshme të shënuara janë të përafërta, llogaritur për një periudhë 36 mujore, dhe nuk janë në asnjë mënyrë detyruese për Autoritetin Kontraktor. Ato janë vendosur me qëllim vlerësimin e njëjtë të të gjitha ofertave të Operatorëve Ekonomikë.**

Afati për kryerjen e shërbimit: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj duke filluar nga data e lidhjes së kontrates,

Afatet e ekzekutimit: Kryerja e shërbimit do të fillojë menjëherë pas nënshkrimit të kontrates/marrëveshjes kuader me afat 36 muaj, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

Për arsye të krijimit të një sigurie në kryerjen e shërbimit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohë dhe pa probleme të evadimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore nisur dhe nga ecuria e procedurës që po zhvillohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Autoriteti Kontraktor do të lidhë me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedura e prokurimit, kontratë bazuar në nevojat e tij për këto shërbime çdo 12 muaj, në bazë të nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Perjashtimisht ketij percaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë lidhur me kete sherbim, që del e parashikuar dhe është e domosdoshme në cdo kohë.

Per çdo kontrate të lidhur sipas percaktimit më sipër afatet e lëvrimit do te jene sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor.

## **Shtojca 8.**

### **FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti: **"Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve spitalore"** (*Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomikë - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 mujor*)

Qëllimi i shërbimit: Realizimi i proceseve te grumbullimit, transportit, magazinimit të përkohshëm, trajtimit të mbetjeve spitalore si dhe evadimit për asgjesim të tepricave që rezultojnë nga trajtimi, me qëllim që i gjithë procesi i menaxhimit të mbetjeve spitalore të sigurojë zvogëlimin e rrezikshmërisë së tyre dhe optimizimin e grumbullimit, transportit dhe trajtimit të tyre deri në evadimin përfundimtar me asgjësim të tepricave.

#### DETYRAT:

Operatori Ekonomik fitues duhet të realizojë shërbimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve spitalore, sipas kontratave përkatëse të shërbimit që do të lidhen nga AK.

Operatori ekonomik ka detyrim brenda cmimit te bej trajnimin e personelit ne fillim te periudhes qe do te behet kontrata per menyren e perdorimit te kontenitoreve/amballazheve dhe menyren e ndarjes dhe grumbullimit te mbetjeve.

Elementët përbërës të shërbimit dhe detyrat specifike që duhet të kryhen nga Operatori Ekonomik fitues (Kontraktori), janë si vijon:

#### 1. Sigurimi për Autoritetin Kontraktor i bazës materiale për Mbetjet Spitalore

Kontraktori do të jetë përgjegjës, që gjatë të gjithë periudhës së shërbimit, brenda vlerës së shërbimit të kontraktuar dhe sipas nevojës së AK, të furnizojë AK me bazën materiale të nevojshme që do të përdoren nga AK për ambalazhimin etiketimin dhe grumbullimin e vecantë dhe e mbetjeve spitalore të prodhuara sipas rrymave përkatëse.

Grumbullimi i vecantë është ndarja në burim nga vetë AK e mbetjeve spitalore të rrezikshme nga ato të parrezikshme, dhe të mbetjeve të rrezikshme në rryma të vecanta sipas kodeve të paragrafit 18, të VKM nr.402, datë 30.06.2021 "Për miratimin e katalogut të mbetjeve" (Shtojca 1). Mbetjet spitalore të parrezikshme, që në mënyrë të vullnetshme apo të pavullnetshme përzihen me mbetje spitalore të rrezikshme, trajtohen si mbetje të rrezikshme.

Baza materiale për ambalazhimin e mbetjeve spitalore duhet:

- i. Të mos lejojnë rrjedhjen, të jenë të papërshkueshme ndaj lagështirës dhe të forta për të parandaluar grisjen, çarjen apo shpimin në kushte normale përdorimi.
- ii. Të mos ripërdoren nëse janë një përdorimëshe dhe të pastrohen dhe dezinfektohen pas çdo përdorimi nëse janë disa përdorimshe apo në rast ndotje me ndonjë mbetje spitalore.
- iii. Të sigurojnë mbyllje të sigurtë, në një mënyrë që të parandalohet derdhja e mbetjeve spitalore gjatë transportit.
- iv. Të jenë të padëmtuara dhe pa ndonjë defekt tjetër që mund të çënojnë përdorimin e tyre të sigurt.

Kodi i ngjyrave të bazës materiale për mbetjet spitalore duhet të jenë si më poshtë:

<b>Mbetja (Kodi)</b>	<b>Ena mbajtese</b>
18 01 01	Kuti të posacme për të mprehtat njëpërdorimshe – e verdhë me kapak të verdhë, ose te bardhë. Me kapak te kuq ose lejla për të mprehtat të ndotura me citotoksike
18 01 02	Qese të verdha ose kafe sipas rrymes se mbetjeve për përdorim nga pavionët, te mbledhura në frigorifer në dhomën e magazinimit në kosha plastike shumëpërdorimësh të verdhë.
18 01 03	Kosh i verdhë një ose shumëpërdorimësh, i pajisur me qese të verdha me mbyllje hermetike
18 01 08	Kuti të posacme njëpërdorimëshe të kuqe

Baza materiale për ambalazhimin e mbetjeve spitalore duhet të të plotësojnë kërkesat përkatëse të përcaktuara në Specifikimet Teknike. Para magazinimit të përkohshëm nga AK në pritje të tërheqjes nga Kontraktori, kontenierët e mbetjeve spitalore të rrezikshme mbyllen dhe etiketohen sipas rrymave të vecanta. Materialet etiketuese duhet të vihen në dispozicion nga Kontraktori dhe duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara për to në Specifikimet Teknike.

Magazinimi i përkohshëm nga AK i mbetjeve spitalore të rrezikshme bëhet në një vend të caktuar, që përmbush kërkesat e posacme të përcaktuara në VKM përkatëse dhe të etiketuar posacërisht për këtë qëllim. Materialet etiketuese duhet të vihen në dispozicion nga Kontraktori dhe duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara për to në Specifikimet Teknike.

Nëse AK prodhon mbetje patologjike kodi 18 01 02, Kontraktori duhet te japë në përdorim dhe të instaloje frigorifer ne ambientet e magazinimit të përkohshëm të AK me kapacitet të mjaftueshëm për nevojat e AK përkatëse dhe temperature - 18 C per ruajtjen e mbetjeve patologjike deri ne momentin e marrjes në dorëzim nga Kontraktori.

## 2. Marrja në dorëzim dhe transportimi i Mbetjeve Spitalore

### 2.1 Frekuenca

Frekuenca e tërheqjes dhe marrjes në dorëzim të mbetjeve nga Kontraktori sipas rrymave përkatëse do të jetë si vijon:

Frekuenca e tërheqjes dhe marrjes në dorëzim të mbetjeve nga Kontraktori do të jetë te pakten nje here ne jave. Kontraktori në momentin e marrjes në dorëzim duhet të pranohet për transportim vetëm mbetjet spitalore që janë ambalazhuar, etiketuar me materialet e dorëzuara nga Kontraktori në përputhje me kërkesat e Specifikimeve Teknike, si dhe janë magazinuar nga AK në përputhje me kërkesat e VKM të posacme për rregullat e menaxhimit të mbetjeve spitalore.

Pas verifikimit si më sipër të plotësimin të kërkesave për ambalazhimin, etiketimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, si dhe kushtet e magazinimit nga AK, Kontraktori merr në dorëzim mbetjet spitalore për t'i transportuar në vendin e trajtimit.

### 2.2 Peshimi

Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshore e kolauduar nga Drejtorja e Metrologjisë, që duhet të vihet në dispozicion nga ana e Kontraktorit, i cili duhet gjithashtu ta shoqërojë me certifikaten e kolaudimit përkatës.

Mbetjet e destinuar për tu dorëzuar, do të peshohen në praninë e përfaqësuesit të Kontraktorit dhe përfaqësuesit të AK dhe do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar.

### 2.3 Dezinfectimi

Kontenierët e mbetjeve spitalore të ripërdorshëm dhe kontenierët për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve spitalore të dezinfektohen pas çdo zbrazjeje. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Kontraktorit do të bëhet dezinfektimi i ambientit nga ku do të tërhiqen mbetjet spitalore të magazinuar prej AK, përfshirë dezinfektimin e frigoriferit dhe ambientit përreth kur është rasti.

### 2.4 Marrja në dorëzim:

Dorëzuesi dhe marrësi i mbetjeve spitalore plotësojnë dhe mbajnë nga një kopje të firmosur të Dokumentit të Dorëzimit të Mbetjeve (DDM) sipas Shtojcës 1 të VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, i ndryshuar dhe ndryshimeve ligjore që mund të ndodhin.

### 2.5 Transportimi

Transportimi i mbetjeve spitalore kryhet me mjete të cilat përmbushin dhe respektojnë kërkesat dhe rregullat mbi qarkullimin rrugor, kushtet higjienike, shëndetësore dhe kushtet mjedisore, sipas përcaktimeve të detajuara në Specifikimet Teknike. Mjetet e transportit të mbetjeve spitalore të rrezikshme të jenë të pajisur me Akt-Miratimi Higjieno-Sanitar.

Cdo automjet duhet të pastrohet dhe dizinfektohet tërësisht në pjesën e brendshme të trupit të automjetit pas çdo dite pune si dhe në rast derdhje ose ndotje me ndonjë mbetje spitalore.

Automjetet duhet të mos përdoren për qëllim tjetër përveç transportimit të mbetjeve spitalore. Gjatë transportimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme, automjetet të mbajnë me vete veshje të mjaftueshme të sigurinë, pajisje të dekontaminimit dhe pastrimit dhe materiale për trajtimin e derdhjeve (p.sh. veshjet mbrojtëse personale, qese plastike dhe kuti të mprehtash rezervë, dezinfektues, kokrriza absorbuese, furça, fshesa leckë, lopatë dhe kova.

## 3 Trajtimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme

Kontraktori, në cilësinë e marrësit të mbetjeve spitalore duhet të jetë i pajisur gjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit me Licencë, Leje të Mjedisit dhe Akt-Miratim Higjieno-Sanitar, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Trajtimi i mbetjeve spitalore kryhet nga subjektet e licencuar, në impiantet për trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, që duhet të jenë të licensuar dhe të respektojnë kërkesat sipas legjisllacionit në fuqi për lejet dhe licencat.

Pajisja me leje mjedisore dhe licensë përkatëse e operatorëve ekonomik dhe impianteve për trajtimin e mbetjeve është kusht për kualifikimin. Lejet Mjedisore përkatëse duhet të përmbajnë të dhëna të detajuara që identifikojnë qartë: metodën e trajtimit, teknologjinë e impianteve, llojin dhe tipin e impiantit, vendndodhjen, kapacitetet, ciklet dhe proceset e punës së impianteve.

A. Trajtimi i mbetjeve spitalore të kryhet me metoda të standartizuara. Proceset bazë për trajtimin e mbetjeve spitalore janë si vijon:

- i. termik: ky proces përdor energjinë termike për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- ii. kimik: ky proces përdor dezinfektantë si dioksid klori i tretur, hipoklorit natriumi, acid peracetik, solucion gëlqereje, gaz ozoni ose kimikate të thata inorganike (p.sh. pluhur oksid kalciumi) për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- iii. mekanik: ky proces përfshin copëtimin, bluarjen, përzierjen dhe ngjeshjen me qëllim përmirësimin e shkallës së transferimit të nxehtësisë, depërtimit të avullit dhe kontaktit me dezinfektantin kimik si dhe për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve, për t'i bërë mbetjet e trajtuara të panjohshme ose për të shmangur dëmtimin fizik në rastin e mbetjeve të mprehta të trajtuara. Ky proces nuk mund të shkatërrojë patogjenët, por plotëson proceset e tjera të trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme.

B. Llojet e pranueshme të teknologjive për trajtimin e mbetjeve spitalore

#### a. Teknologjitë termike pa djegie

- i. Autoklavat – trajtimi kryhet përmes nxehtësisë së mbetjeve nga avulli nën presion.

- ii. Sistemet e integruara (ose autoklava të avancuara apo autoklava hibride) - kombinojnë trajtimin me avull me procese të tjera mekanike si ngjeshje, copëtim, grirje, para, gjatë ose pas trajtimit;
  - iii. Trajtimi me nxehtësinë e fërkimit - përdor nxehtësinë e fërkimit të plotësuar nga ngrohësit me rezistencë për të nxehur mbeturinat, ndërkohë mbetjet coptohen në kokrriza të thata.
  - iv. Sistemet e nxehtësisë së thatë – nxehtësia aplikohet pa shtuar avull ose ujë. Mbetjet nxehen nëpërmjet përçimit, konveksionit natyror ose të detyruar dhe/ose rrezatimit termik.
- b. Teknologjitë kimike
- i. Hidroliza alkaline - shndërron mbetjet patologjike në një tretësirë ujore të dekontaminuar.
- c. Teknologjitë me djegie.
- i. Inceneratorët – trajtimi bazohet në procesin e oksidimit të thatë dhe temperaturës së lartë që kthen mbetjet organike dhe të djegshme në lëndë inorganike dhe të padjegshme dhe që rezultojnë në një reduktim të ndjeshëm të vëllimit dhe peshës së mbetjeve”.

C. Kontraktori dokumenton dhe regjistron në një regjistër të posacëm, minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- a. numrin e identifikimit të ciklit të trajtimit;
- b. sasinë ditore, llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;
- c. datën, orën e fillimit dhe mbarimit të ciklit të trajtimit;
- d. temperaturën dhe presionin;
- e. subjektin/vend-depozitimin ku dorëzon për asgjësim tepricat e krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të asgjësuesit të këtyre tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara;
- f. Të dhënat për lejen e mjedisit A ose B, të licencës III.2.B dhe Kodin Unik të asgjësuesit të tepricave të mbetjeve spitalore;

D. Asgjësimi i tepricave që rezultojnë nga trajtimi i mbetjeve spitalore

Kontraktori është përgjegjës për tu siguruar për evadimin përfundimtar me asgjësim të tepricave që rezultojnë pas trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Procesi i asgjësimit të tepricave, mund të realizohet nga vetë Kontraktori, nëse është i pajisur me Leje Mjedisore dhe Licensën përkatëse për këtë proces, ose nga subjekte të tjera të pajisur me Leje Mjedisore e Licensë përkatëse, me të cilët Kontraktori duhet të ketë kontratë aktive në momentin e dorëzimit të ofertave dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Kuadër do të jete përgjegjës që të mundesoje që ky shërbim të vazhdojë sipas standarteve dhe rregullave në fuqi.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë të sterilizuara:

- a) mund të dërgohen për rikuperim në impiantet termike të prodhimit të energjisë;
- b) mund të asgjësohen në impiantet e djegies së mbetjeve urbane ose në impiantet speciale të djegies së mbetjeve;
- c) nëse nuk ka impiante sipas germës a) dhe b), mund asgjësohen në landfille për mbetjet jo të rrezikshme.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë HI

Hiri nga incineratori dhe tepricat e tjera të ngurta të prodhuara, depozitohen në landfille për mbetje jo të rrezikshme, nëse testet vërtetojnë se nuk paraqesin rrezik sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për mbetjet. Në të kundërt, trajtohen si mbetje të rrezikshme dhe mund të depozitohen në landfille për mbetje të rrezikshme, ose të magazinohen nga Kontraktori deri sa të kontraktojnë landfillin e mbetjeve të rrezikshme, ose në pamundësi të disponueshmërisë së një landfilli të mbetjeve të rrezikshme, të realizojë procedurat e nevojshme për eksportin e tyre, dhe ti dokumentojë procesin.

Autoritetit Kontraktor për procesin e asgjësimit të tepricave të mbetjeve spitalore, kur asgjësuesi i tyre është i ndryshëm nga Kontraktori, dokumenton dhe regjistrohen në një regjistër minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- a. Të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të dorëzuesit të mbetjeve spitalore;
- b. Llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;
- c. Sasinë e dorëzuar të tepricave të mbetjeve (në kg);
- d. Datën e dorëzimit;
- e. Numrin e lejes së mjedisit, numrin e licencës III.2.B dhe Kodin unik të dorëzuesit të tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara të dorëzuara për asgjësim;

Në çdo rast të sipërpërmendur mbahet parasysh parashikimi i nenit 44, të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, për të përjashtuar nga depozitimi në landfill mbetjet spitalore të patrajtuara fillimisht në impiante të trajtimit të mbetjeve spitalore.

#### d. Monitorimi

Autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të kontrates së lidhur me OE fitues është përgjegjës për plotësimin e kërkesave për monitorimin e respektimit të detyrimeve nga OE. Për këtë, subjekti i licensuar i kontraktuar detyrohet t'i dorëzojë prodhuesit të mbetjeve, nëse është e mundur në çdo marrje në dorëzim pasardhëse të mbetjeve spitalore, por jo më vonë se 2 (dy) muaj nga marrja në dorëzim e tyre, dokumentacionin për realizimin e proceseve të menaxhimit të mbetjeve spitalore të kontraktuara.

*(Specifikimet teknike dhe Termat e referencës janë hartuar konform nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku citohet “Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet si dhe janë conform VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’” dhe Udhëzuesit Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore. Ne rastin aktual specifikimet teknike dhe termat e referencës janë te qarta dhe përcaktojnë sakte menyrën e kryerjes së shërbimit të kërkuar dhe janë vendosur nga specialisti i fushës nga anetaret e njesisë së prokurimit në përputhje me legjislacionin aktual në fuqi).*

Njesia e prokurimit, referuar nenit 42 pika 5 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

**Afati i fundit për pranimin e dokumentave dhe data e zhvillimit të tenderit, do të jete data 27.02.2025 ora 10:00. Vendi [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al); Spitali Fier.**

*(Mbeshtetur në pikën 5 të nenit 42 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. pika 2. Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal për pranimin e ofertave është jo më pak se 35 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës. dhe pika 4. Afati për dorëzimin e ofertave, përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, mund të shkurtohet me 5 ditë kur ofertat paraqiten me mjete elektronike.” si dhe duke pasur parasysh se shpallja e njoftimit të kontrates në faqen e internetit të APP-se behet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes në sistem të njoftimit, afati i vendosur nga NjP është brenda afatit ligjor perkates).*

**NJESIA E PROKURIMIT**